

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi dhe me sekretaren Vildane Azemi-praktikante, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.E., për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP//nr.894-5/14 të dt. 10.02.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e Prokurorit të Shtetit Visar Musa, të dëmtuarit T.S. dhe të pandehurit F.E., me datë 04 Korrik 2016 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 11 Korrik 2016, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: F.E. data e lindjes....., nga i ati I. dhe nëna H. e gjinisë T., me vendbanim ne Rr. “.....”, llamella ., kati ... në Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 30.09.2013, rreth ores 12:10, ne Rr. “Rexhep Bislimi” ne Ferizaj, ka uzurpuar ne mënyrë te kundërligjshme pronën e paluajtshme të dëmtuarit M.C., te cilën e përfaqëson sipas autorizimit Vr.Nr. 1798/2007, T.S., dhe atë banesën llamella ., kati .., numër .., i cili edhe përkundër marrëveshjes për lirim e banesës i njëjti ka refuzuar ta liroj te njëjtën dhe ende e mban ne mënyrë te kundërligjshëm duke qëndruar.

me këtë kreu veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit te sipërcekuer dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 51, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N
D Ë N I M M E K U S H T E

- **Të pandehurit i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ Muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 /një/ viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.**
- **I pandehuri urdhërohet ta liroj objektin banesor: llamella ., kati ..., numër e cila gjendet ne Rr. “Rexhep Bislimi” ne Ferizaj.**
- **Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor te paguaj shumë prej 30 € në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcenim te ekzekutimit me dhunë.**
- **I dëmtuari T.S. nga Lipijan, për realizimin e kërkesë pasuroro-juridike, udhëzohet ne contest civil.**

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm në Ferizaj, ka sjellë për gjykim çështjen penale sipas aktakuzës PP.nr.894-5/14 dt. 10.02.2015, në ngarkim të pandehurit F.E. nga Ferizaj, të akuzuar për veprën penale të uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së, dhe ne shqyrtim gjyqësor ka propozuar që te i shqiptojë sanksion penal te parapar me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet

Përpara kësaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 04.07.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari F.E. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bere paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit te tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëren tjetren, ne kuptim te nenit 361 par. 1 dhe 2 te KPPK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve te përshkruar hollësisht ne dispozitivin e këtij aktgjykimit:

Rrethanat e faktit te çeshtjes lidhur me kete procedim kane rezultuar si me poshte:

Me date 27/03/2014, ankuesi T.S. ka paraqitur rastin uzurpim prone ne policia e Kosoves, i njëjti ka dorzuar dokumentacionin e nevojshme qe vërteton se T.S. eshte pronar legjitim i banesës qe është objekt uzurpimi. Pas hapjes se rastin ne PK-Ferizaj, eshte intervistuar ne cilsine e te dyshuarit F.E. i cili e shfrytëzon ketë banës edhe perkunderfaktit se i dyshuari pranon se banesa nuk eshte prone etij i njeti e shfrytëzon sipas marrveshjes me pronarin T.S. nën ndermjetsimin e zyrës per ndërlidhje me gjykata ne Ferizaj. Edhe pse egziston marrveshja i pandehuri kete marrveshje nuk e njef pasi beson se e ka nënshkruar nën ndikimin e barnave dhe nuk do ta liron banesën deri sa te mirrët nje vendim i prerë nga Gjykata ne kontestin civil ndërmjet A.I. dhe T.S..

I dëmtuari T.S., ne lidhje me këtë procedim penal ka deklaruar ne shqyrtimin gjyqësor se: une pronarin M.C. e kam dhëndër dhe se posedoj autorizim per kete banesës, veprimin e para per kete banesë ka qene marrja e qelsave nga Habitati ne vitin 2006, pastaj kam shkuar te banesa aty kam hasur vetëm nje shtrat dhe pastaj kam mbyll me qelës banesën, pas kesaj A.I. i ka

ndërruar dhe vendos dere te blinduar dhe me ndimen e policisë e kam hequr derën e tij, zyra per ndërlidhje me gjykatën qe e perfaqsonte R.S. jemi marre vesh qe ta gjejnë dike per ta blere ose ta gjeje nje shfrytëzues te ndershëm, pas kesaj zyra e sipërcekur ka bere nje far marrveshje me F.E. qe ky i fundit te hyje ne banës dhe ta mirëmbaj, une nuk kame qene prezent dhe as nuk kam nenshkru ndonjë marrveshje, pas hyrjes te F.E. ne banës une personalisht dhe R.S. (ndërlidhësi me zyre), kemi vizituar F.E.n dhe i njëjti na ka pritur mire ne banës dhe ka thene se kur te doni ta liroj banesën dhe nuk do te kete kurrfarë problemi. Ne kemi kërkuar ta liroj banesën mirëpo F.E. nuk ka pranuar ta liroj banesën edhe përkundër marrëveshjes me shkrim qe ta liroj.

Dëshmitari R.S., ne lidhje me këtë procedim penal ka deklaruar ne shqyrtimin gjyqësor se: ne vitin 2012, kam punuar ne zyrën per ndërlidhje me Gjykata, ne ju kemi ofruar ndime minoriteteve rreth kontakteve me gjykata, komunë si dhe nxjerrjen e dokumente ne institucione te Kosovës, po kame perpilu nje marrveshje te dt. 13.07.2012, F.E. ka qene prezent ndersa T.S. nuk ka qene prezent ndërsa me vone nuk e dij nëse e ka nënshkruar, por kemi pas te drejt te bëjmë kësi lloj marrëveshje qe me pëlqimin e palës-pronarit, po kam njohuri qe promari ka kerku lirimin e banesës por deri me tani nuk eshte liruar, për këtë marrëveshje te dyte i dij qe F.E. ka pas ta liru banesën.

I pandehuri F.E. ne lidhje me këtë procedim penal ka deklaruar ne shqyrtimin gjyqësor se: para se te hy ne kete banës une kam banur ne at lagje edhe pse banesat nuk kan qene te miat te njëjtat i kam liruar, banesën qe jemi sot në gjykat une e kam pëlqimin e R.S. dhe T.S., pasi kjo banës ishte e zbrazur me eshte leju te hyjë, ta mirëmbaj, diri sa te përfundoj kontesti gjyqesor ndërmjet A.I. me T.S., ky i fundit ka ardhe tek une per te bisedu rreth shitblerjes se banese mirëpo nuk kemi mund te mirremi vesh, sai përket marrëveshjes se dyte unë kam pasur shumë presion nga T.S. dhe policia për ta liruar banesën dhe kurdoherë jam i gatshëm ta blej, jetoj ne banesën llamella ., kati ..., nr.

Sa më sipër, u provua ne gjykimin e çeshtjes me provat e paraqitura nga organi i akuzes dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, nder të cilat theksohen: ekzistenca e faktit eshte provuar se i pandehuri e ka bere uzurpimin e paligjshem te pronës dhe endne vazhdon , kjo vërtetohet edhe me;

- Marrëveshja për shfrytëzimin e banesës te dt. 13.07.2012,

- Marrëveshja rreth banesës te dt. 13.06.2013,
- Kontrata per shitblerjen e banesës dt. 22.01.2014,
- Autorizimi i dt. 07.05.2007.

Argumentat juridike, interpretimi i dispozites penale referuese, analiza e provave dhe konkluzionet e Gjykates.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara faktit te parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se në veprimet e të pandehurit F.E. janë të pranishëm te gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal për t'i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të pushtim i paligjshem i prones se paluajtshme, ne dem te te dëmtuarit T.S., të parashikuar nga neni 332 par. 1 te KPRK-së.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoj nga dëgjimi i deshmitarit/demtuarit T.S., R.S., të cilet në mënyrë bindëse dhe objektive dëshmoj për faktet relevante, kohen dhe vendin dhe mënyrës se si i pandehuri ka ardhë deri te hyrja ne banës, mosrespektimin e marrveshjes, për këtë edhe kam lajmëruar policin pasi nuk ka pranuar deri me tani te ai lirojnë banës te dëmtuarit edhe përkundër kërkesës per lirim. Se banesa ne fjale nuk eshte prone e te pandehurit kete e vërteton edhe kontrata per shitblerje te banesës e lidhur ne mese Agjencisë Kosovare te Privatizimit dhe M.C. te përfaqësuar me autorizim Vr.Nr. 1798/2007 nga T.S., te nënshkruar nga palët me dt. 22.01.2014.

“Gjykata gjene se, neni 332 i KPRK-së, parashikon: “Uzurpim I paligjshem i prones perben veper penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjere ne dy vjet”

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme në mënyrë që shkelja e kësaj dispozite të cilësohet nga ligji si vepër penale duhet që: objekt i veprës penale të jenë marrdheniet juridike te vendosura me ligj qe sigurojne regjimin juridik te prones te mbrojtuar posaçerisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale me veprime aktive, të kundraligjshme të ketë shkelur ligjin. Këto shkelje duhet të kenë sjellë pasoja për personate tjere ose komunitetin si pushtimit pa te drejte te tokes ne deme te prones se tjetrit ose duke e zene pa leje token.

Nga ana subjektive, uzurpimi i tokes kryhet me dashje, nga personi I pergjegjshem dhe me veprime aktive.

Vlersimi i mbrojtjes: ne shqyrtimin gjyqësorë i pandehuri F.E. edhe përkundër qëndrimit mohues se nuk është uzurpator, pranon faktin se ka në shfrytëzim banesën lllamella ., kati ..., nr. ..., ka kontaktuar disa here me te dëmtuarin per mundësin e blerjes te kesaj banesa, pranon edhe faktin se banesën e ka ne shfrytëzim sipas marrveshjes te dt. 13.06.2013, mirpo kete marrveshje e ka nënshkruar me shumë presion nga ana e T.S., por një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj, nga fakti se i pandehuri nuk ishte ne gjendje te ofroj një fakt me te cilin do ta provonte se nuk është uzurpues i pasurisë se paluajtshme te huaj, marrveshja ne fjale eshte me kohe te caktuar dhe i pandehuri pas datës te skadences ka qene i obliguar ta liroj o me kërkesë ose pa kërkesë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjukata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh sjelljen e tij korrekte, nuk është i evidentuar si kryes i veprave penale nga kjo gjykatë, ndërsa ne mungese te rrethanave veqanarishte renduese Gjukata vlerësoj shkallen e përgjegjësisë penale për te pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete te veprës penale, mbi baze te këtyre rrethanave i vërtetoj dënimin si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjukata të pandehurit i shqiptoj dënim me burg prej 6 /gjashtë/ Muaj te cilin dënim urdheron te mose exekutohet nëse i pandehuri në afatin prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, si duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, qëllimi ndëshkimor te dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale sa i paraparë nenit 41 të KPRK-së.

I demtuari T.S. nuk ka paraqite kerkese pasurore-juridike dhe nuk i eshte bashkangjitur ndjekjes penale per te akuzuarin.

Konformnenit 450-451 të KPPK-së, obligoheti akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € pas plotfuqishmëris së aktgjykimit nën kërcnimin te ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I
PËRGJITHRSHËM, P.nr.208/2015, me datë 11.07.2016.**

**Sekretare Juridike,
Mimoza Shabani**

**Gjyqtari Individual,
Ilir BYTYQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.